

HUMANUS

ISSN: 2518-8321

Revistë e disiplinave
mbi individin dhe shoqërinë



HUMANUS

2017 - Nr. 3

Përmbajtja

PËR NJË MORAL PA ZOT <i>IMAGINE THERE IS NO HEAVEN</i> Fatos Tarifa	1
ESE	
E ARDHMJA E HUMANIZMIT SHPRESA PËR NJË SHOQËRI TË SEKULARIZUAR Ronald A. Lindsay	11
KONSIDERATA TË REJA PËR HUMANIZMIN DHE SHKENCËN Ann Brail & Anthony Grafton	15
LULJA E SHKENCËS RËNDËSIA E HUMANITETEVE PËR SHOQËRINË André Lardinois	23
RËNDËSIA E MËSIMIT TË ARTEVE NË SHKOLLË Wendy Earle	35
FËMIJËVE T'U MËSOJMË SE SI TË ENDËRROJNË Tom Goodwin	45
IMPERATIVI I LUMTURISË NË DIKTATURË Arnisa Tepelija	51
SOCIOLOGJIA E ALTRUIZMIT Jay Weinstein	57
INVESTO NË HUMANIZËM, INVESTO NË LUMTURI Babeta Rexhepi	63

FORMIMI MORAL DHE ARSIMIMI Enes Karić	67
LETËRSIA, FUTURIZMI DHE GLOBALIZMI Moikom Zeqo	75
ÇFARË VEPRE ËSHTË NJERIU! HUMANIZMI DHE GJENIA SHEKSPIRIANE Bavjola Shatro	81
BACH DHE MOZART MISHËRIME TË KOHËS SË TYRE Pilar Montero & Arthur Colman	93
NJË IKONË E PAVDEKSHME AUGUSTE RODIN DHE 'MENDIMTAR' I TIJ Joe McGasko	99
LE JARDIN D'EPICURE	
MBI DASHURINË DHE SEKSIN Martin Logu & Valeria Buda	109

Shënime për autorët

Fatos Tarifa është Profesor i Sociologjisë dhe i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në University of New York Tirana dhe Rektor i këtij universiteti. Ai ka fituar gradën PhD në sociologji nga University of North Carolina, Chapel Hill, dhe është anëtar i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave.

Ronald A. Lindsay është një jurist dhe filozof amerikan. Ai ka fituar diplomën si jurist nga University of Virginia dhe gradën PhD në filozofi nga Georgetown University.

Ann Blair është Carl H. Prorzheimer University Professor në Harvard University. Ajo ka fituar gradën PhD në Histori nga Princeton University.

Anthony Grafton is Henry Putnam University Professor në Princeton University. Ai ka fituar gradën PhD në Histori nga University of Chicago dhe është anëtar korrespondent i British Academy.

André Lardinois është Profesor i gjuhëve dhe kulturave greke e latine në Radboud University, Nijmegen (Hollandë). Ai ka fituar gradën PhD nga Princeton University.

Wendy Earle është profesoreshë në Birkbeck, University of London, si dhe drejtuese e Institute of Ideas/Arts and Society Forum në Londër. Ajo ka fituar gradën PhD nga University of London.

Tom Goodwin punon për Zenith Media, dhe shkruan, gjithashtu, për *Guardian*, *Forbes*, etj. Ai është diplomuar për arkitekturë nga University of Sheffield dhe jeton në New York.

Arnisa Tepelja është diplomuar për të Drejtë Europiane dhe Studime Europiane në Centre Internationale de Formation Européenne (Nice, Francë). Ajo është anëtare e EU Policy Hub dhe merret me monitorimin e institucioneve që lidhen me Integrimin European.

Jay Weinstein ishte Profesor i Sociologjisë në Eastern Michigan University dhe anëtar i bordit botues të revistës *Humanus*. Ai kishte fituar gradën PhD në sociologji nga University of Illinois, Urbana-Champaign. Vdiq në mars të këtij viti.

Babeta Rexhepi është diplomuar për Infermieri në Universitetin e Tiranës, ku edhe ka fituar gradën MSc. Ajo ushtron profesionin e saj prej 10 vitesh.

Enes Karić është Profesor i Studimeve mbi Kur'anin në Fakultetin e Studimeve Islame, Sarajevë. Ai ka fituar gradën PhD nga Universiteti i Beogradit dhe ka qenë Ministër i Arsimit, Shkencës, Kulturës dhe Sportit të Republikës së Bosnje-Hercegovinës.

Moikom Zeqo është Doktor i shkencave historike, shkrimtar, poet, arkeolog, kritik letrar, historian i artit, si dhe anëtar i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave. Ai ka qenë anëtar i Parlamentit dhe Ministër i Kulturës i Shqipërisë.

Bavjola Shatro është Professore e Asociuar e letërsisë botërore të shekullit të 20-të dhe e letërsisë bashkëkohore shqipe në Universitetin Aleksandër Moisiu, Durrës.

Pilar Montero është një analiste jungiane në praktikë private dhe në C. G. Jung Institute (San Francisco). Ajo ka fituar gradën PhD në Psikologji Sociale dhe ka dhënë mësim në University of California Medical Center dhe në San Francisco State University.

Arthur D. Colman është një analist jungian dhe Clinical Professor në Psychiatry. Ai jeton në San Francisco.

Joe McGasko është një eseist amerikan që shkruan për 'pop culture'. Ai jeton dhe punon në New York City.

Martin Logu dhe **Valeria Buda** janë pseudonimet e dy autorëve shqiptarë që shkruajnë për çështje të sociologjisë, të filozofisë, të politikës e të moralit.

Formimi moral dhe arsimimi


ENES KARIĆ

Një alegori e famshme, e cituar në shkrimet e shenjta, na rrëfen sesi filozofëve dhe *ulematëve*, në një debat përpara vetë Kalifit, do u duhej të argumentonin se cila është ajo veti që mbizotëron te qenia humane, karakteri apo arsimimi, origjina apo edukimi, gjaku që rrjedh në vena apo djersa në bankat e shkollës.

Filozofët pohuan se edukimi qëndron mbi karakterin. Përgjatë debatit, ata mbrojtën pikëpamjen se arsimimi i zbut kompleksitetin dhe karakterin e njeriut dhe e kapërcen qenien. *Ulematët*, nga ana e tyre, argumentuan se, te njeriu, madje edhe pas arsimimit të tij, mbizotërojnë pasioni dhe karakteri, veçanërisht në kohërat e djallit, të luftës, të trazirave e të mosmarrëveshjeve. Karakteri është gjithnjë më i fuqishëm sesa arsimimi i thjeshtë, veçanërisht në kohëra të tilla, pasi ai, në vetvete, është i pandryshueshëm—sido që të jetë, gjendet në gjak. *Ulematët* argumentuan më tej se, arsimimi është një gjë, ndërsa formimi moral është një gjë krejt tjetër. Vetëm një formim moral i mirë, krahas një arsimimi të plotë, mund të shërbejë si ajo porta e komanduar që kontrollon valët e mëdha të karakterit që gjenden në thellësi të qenies.

Kalifi i dëgjoji me kujdes të dyja palët dhe kërkoi nga secila që të parashtronte provat e veta. Të nesërmen, filozofët, për të argumentuar se arsimimi është më i rëndësishëm sesa karakteri, sollën si provë një mace, të cilën e kishin stërvitur që të përdorte putrat e saj për t'u shërbyer kupat e çajit të pranishmëve në atë tubim. Dhe vërtet, macja u serviri pjesëmarrësve në debat pijen e tyre të preferuar. Dukej se *ulematët* po e humbisnin debatin. Sidoqoftë, edhe pse ata dukeshin tashmë si të

shushatur, i kërkuan Kalifit që të mblidheshin përsëri një natë më pas, në mënyrë që macja e filozofëve t'ua dëshmonte atyre sërish aftësitë që i kishin mësuar ata. Të nesërmen, në një çast të dhënë, kur macja po u shërbente të pranishmëve në atë tubim kupat me çaj, *ulematët* nxorrën nga xhepat e xhybeve të tyre disa minj dhe i vunë ata përballë maces. Macja i lëshoi menjëherë kupat me çaj për t'iu turrur minjve.



Natyrisht, njerëzit nuk janë minj, por ky ilustrim i vjetër dhe teoria e formimit moral e arsimor shprehin rëndësinë e çështjeve kryesore që janë hasur në fillim dhe në mbarim të çdo procesi arsimimi dhe formimi moral. A mundet që njerëzimi të mësohet, ose të shkollohet nga familja dhe nga shkolla apo, mos vallë kërkohet që, në të njëjtën kohë, të ushqehet edhe me atë që është e fisme në karakterin e njeriut? Çdo fe dhe çdo kulturë jo vetëm që e ka shtruar këtë pyetje, por edhe i është përgjigjur asaj në mënyra të ndryshme. Në këto kohëra globalizmi, kjo pyetje është bërë thelbësore për shumë shoqëri, veçanërisht për ato që kanë përqaftuar ideologjitë e arsimimit. Në shekujt e 19-të dhe 20-të, për herë të parë në histori, arsimimi pushoi që qenuri një çështje vetëm për *ulematët*, për kastën e priftërinjve, për elitat fisnore apo ato sunduese. Gjatë këtyre dy shekujve të fundit, arsimimi është bërë i aksesueshëm thuajse për këdo. Kjo do të duhej të konsiderohej si një gjë shumë e mirë, nëse arsimimi nuk do të ishte zbratur, siç ka ndodhur në të vërtetë, nga formimi moral, ose nëse ai nuk do të ishte shndërruar në arsimim të masës—kjo është dija e transmetuar me klishetë e reja të arsimimit të nxënësve, të studentëve, të njerëzve *en masse*, pikërisht ku ata jo vetëm që nuk janë parë thjesht si një masë, por janë edukuar si masa. Qëkurse masa, në vetvete, përbën një fenomen fizik, jo vetëm që asnjë pjesëtar i saj nuk mundet ta shohë tjetrin në fytyrë brenda masës, por çdo fytyrë, me secilën karakteristikë individuale të saj, humbet brenda vetë masës. Për këtë arsye, shumë ideologji të shekujve të 19-të dhe 20-të, në Perëndim dhe në Lindje, veçanërisht ato që u bënë ideologji të regjimeve në fuqi, e kanë bërë “arsimimin e masave” pjesë të programeve të tyre politike. “Arsimimin e masave” e ndan vetëm një hap i vogël nga kushtëzimi i tyre.

Aty ku regjimet totalitariste ia kanë dalë të vijnë në fuqi, dihet se ato e kanë ndërmarrë këtë hap. Regjime të tilla, jo vetëm që nuk e kanë kufizuar marrjen e njohurive për masat e gjera, por edhe i kanë krijuar dhe përçarur njohuritë e tyre në masat si një tërësi faktesh të izoluara, që i takojnë një disipline të dhënë. Gjatë shekujve të 19-të dhe 20-të, shkenca të tilla, si fizika, kimia apo biologjia u pavarësuan dhe u atomizuan. Trajtimi i njohurive shkencore si një grumbull faktesh jo vetëm që ka bërë të mundur përçimin e tyre të miliona nxënës e studentë në shkolla publike, përmes mediumit të arsimimit masiv, por edhe i ka fragmentarizuar e izoluar këto njohuri

në disiplina të ndara, të cilat me kohë janë shkëputur thuajse tërësisht prej njëra-tjetrës. Kjo ka çuar në një rezultat të tmerrshëm: bota e sotme konsiderohet gjithnjë e më pak si *një e tërë* nga arsimimi modern. Shkencat e kanë copëtuar botën, ashtu si bishat që shqyejnë mishin, duke rrëmbyer secila pjesën e vet.

Ky koncept i arsimimit masiv, i zhvilluar gjatë dy shekujve të fundit, e ka lënë gjithnjë e më shumë pas dore formimin moral të të rinjve, duke mos e përfshirë këtë aspekt në procesin e formimit arsimor. Pasojat kanë qenë ogurzeza e të pashmangshme. Dhomat e gazit të Holokaustit ishin një shpikje e akademikëve me arsimim elitari, por që nuk kishin marrë formimin e duhur moral. Pastrimi etnik është rezultat i projekteve të ëndërruara nga profesorë me formim të lartë akademik, por që nuk kishin pasur po ashtu edhe formimin e duhur moral. Kohët e fundit është shkruar shumë rreth kësaj dukurie, ashtu siç flitet e shkruhet edhe për katastrofën mjedisore në shkallë planetare. Qytetërimi i lashtë zuri rrënjë në brigjet e lumenjve e të deteve; arsimimi modern dhe armatat e njerëzve të mësuar, por pa formimin e duhur moral, i kanë helmuar këta lumenj dhe dete. Askush që ka njëfarë ndërgjegjeje nuk mund të mohojë faktin se arsimimi modern, nga i cili është përjashtuar elementi i formimit moral, ka përgatitur armata shkencëtarësh, që nuk kanë asnjë ndjenjë përlësie përballë natyrës. Kjo dëshmon se sistemi i arsimimit masiv, i zhveshur nga elementi i formimit moral, është shndërruar në një sistem arrogant njohurish të papërgjegjshme. Njeriu i mirinformuar, por i papërgjegjshëm, i ngjan maces për të cilën rrefyem më sipër. Një njeri, ose një shoqëri e arsimuar në këtë mënyrë do të tërhiqen e do të mposhten gjithnjë nga rritja e shpejtë e vulgut dhe e natyrës së papërpunuar. Nën ndikimin e një arsimimi të tillë të papërgjegjshëm, ndikimi i njeriut mbi natyrën është bërë sot tejet më i dëmshëm sesa ai i “njerëzve të egër” të pakultivuar.

Është me vend, në kontekstin e pohimit të mësipërm, të sjellim ndër mend metaforën e njeriut që banesë kishte atë çka i ofronte të gatshme vetë natyra, pra njeriut të shpellës. Kjo është një metaforë e preferuar për fenë, filozofinë, historinë dhe artin. Ashtu si guacka është prej natyre mbi kërmillin që e mban, ashtu dhe njeriu nuk e ka harruar shpellën, duke e ruajtur thellë brenda vetes natyrën e saj ose, të paktën, kujtesën e largët të saj. Megjithatë, feja thotë se kontrapunkti me shpellën ka qenë gjithnjë tempulli (në fenë islame një tempull i tillë njihet si Kaaba), si simbol i besimit dhe masës, i rendit dhe i simetrisë, ose si simbol i edukimit dhe si kufiri se deri ku mund të shkojë njeriu (shpella ka mbetur e ngulitur thellë në zgafellat e kujtimeve të largëta të njeriut). Shpella, zjarri, tymi, gjuetia, plaçka—të gjitha këto janë shndërruar në një cikël historik njerëzor dhe vetë njerëzimi tashmë me vështirësi i reziston joshjes së plaçkitjes.

Arsimimi modern, i zhveshur nga formimi moral, ka çuar në një fenomen absurd:

luftërat e “njerëzve të shpellave” janë si një shaka e pafajshme krahasuar me luftërat e njerëzve të qytetëruar, të armatosur me njohuritë e fituara nga arsimimi i sotëm. Luftërat që kanë shpërthyer gjatë shekujve të 19-të dhe 20-të, përveç faktit se njerëzimi kurrë nuk ka qenë kaq i arsimuar sa në këta dy shekuj, dëshmojnë, gjithashtu, se arsimimi modern jo vetëm që nuk i ka bërë njerëzit e arsimuar të aftë që t’i shmangen joshjes së vjetër të shpellës, zjarrit dhe grabitjes, thirrjes për gjueti dhe plaçkitje, por edhe e ka bërë më të rrezikshme këtë joshje në radhët e tyre, qëkurse ata janë bërë shumë më eficient në ligësi.

Dhjetëra qytete, ndër më të mëdhenjtë e botës, janë djegur nga njerëzimi i arsimuar në luftat e shekullit të 20-të, si në Perëndim dhe në Lindje, pasi njerëzimit të sotëm i mungon formimi moral. Duket sikur ishte vullneti i të gjithë këtij njerëzimi të arsimuar, në kushtet e mungesës së formimit moral, për ta shndërruar botën e sotme në një shpellë, në një imazh të stërmadh të zjarrit, të flakëve dhe të tymit. Xhalaludin Rumi u shkruar se arsyeja i shërben njerëzimit që është i arsimuar, por pa formimin moral, ajo i ngjan një kandili që i shërben hajdutit për të vjedhur.



Vitet e fundit kemi dëgjuar gjithnjë e më shpesh lajme për nxënës që hapin zjarr me automatikë në shkollat e tyre, duke vrarë ose plagosur deri gjysmën e shokëve të tyre të klasës. Lajme të tilla dhe vetë kjo dukuri analizohen sot gjerësisht. Megjithatë, edhe pse përpiqemi që të depërtojmë në thelbin e këtij problemi, pa i shkruar atij deri në fund, nuk kuptojmë se lajmet flasin jo për shkaqet, por për pasojat e tij. Shkaqet, si në Perëndim, ashtu dhe në Lindje, qëndrojnë shumë më thellë; ato shkojnë pas në kohë dy ose më shumë shekuj. Arsimimi masiv dhe shkollat moderne i mirëpresin sot nxënësit e tyre në klasa, me kurrikula efektive dhe tekste shkollore, por tekstet e sotëm të fizikës nuk thonë asgjë për ndjenjën e përlësisë; tekstet e kimisë moderne nuk thonë as edhe një fjalë të vetme për të ashtuquajturën ndjenjë e qëndrimit në hije dhe, po kështu, tekstet e biologjisë moderne as që aludojnë për modestinë.

Dikush mund të dojë t’i shqyrtojë të gjitha disiplinat bashkëkohore dhe do të shohë se tekstet shkollore për këto disiplina nuk përbajnë as edhe elementin më të thjeshtë të ndonjë forme edukimi apo të një konstanteje morale. Për më tepër, në kohën e sotme, ata që insistojnë në përfshirjen e një elementi moral në tekstet shkollore konsiderohen gati qesharakë. Është njëlloj si të thuash se njeriu

*Luftërat e
“njerëzve të
shpellave” janë si
një shaka e
pafajshme
krahasuar me
luftërat e
njerëzve të
qytetëruar, të
armatosur me
njohuritë e
fituara nga
arsimimi i sotëm.*

Formimi moral dhe arsimimi

është njeri vetëm për shkak të virtytit të urtësisë së tij, por jo nga modestia e tij. Kjo dëshmon se në këta tekste shkollore karakteri i njeriut përshkruhet sikur ky të ishte një makinë, pa folur për qëllimin më të lartë, që ekziston përtej nivelit të botës që ne mund ta kuptojmë përmes arsyes sonë. Nuk janë vetëm përvulësia, modestia apo brejtja e ndërgjegjes ato tipare që janë dëbuar nga tekstet shkollore të fizikës, të kimisë e të biologjisë. Njësoj si këto janë zhdukur nga faqet e këtyre teksteve edhe terma të tillë, si hijeshia, mrekullia, bukuria, pafundësia e botës dhe e natyrës. Arsimimi modern ka reshtur së mahnituri, për shembull, me natyrën e mrekullueshme të ujit. Uji prej kohësh është parë thjesht si burim industrial. Të gjitha këto dëshmojnë se tekstet shkollore sot edukojnë, por ato nuk mund ta lartësojnë të riun.



Formimi moral nënkupton, mbi të gjitha, një njohje të qëllimit të lartë dhe të arsyeve eprore të të mësuarit, të njohurive dhe mësimdhënies. Ai është i ngulitur fort në kulturë, në kulturën e besimit dhe në besimin drejt Qëllimit të Fundit. Të njohësh ligjet e hidraulikës, apo të dish se si ndërtohen kanalet e ujit, këto janë çështje që lidhen me arsimimin; por të pastruarit me ujë ka të bëjë me të nxënit

*Arsyeja
i shërben
njerëzimit që
është i arsimuar,
por pa formimin
moral, ajo i
ngjan një kandili
që i shërben
hajdutit për
të vjedhur.*

dhe është, pra, një çështje e kulturës. Të njohësh formulën për prodhimin e sapunit dhe ta prodhosh atë ka të bëjë me shkencën; por ta përdorësh sapunin kur është e nevojshme, kjo lidhet me të nxënit. Të zësh rob trupat e armikut në kohë lufte është një çështje që ka të bëjë me njohuritë dhe aftësitë ushtarake, por të mos i vrasësh ata dhe t'i trajtosh me dinjitet është një çështje që lidhet me të nxënit.

Sistemi modern i duhet t'i rikthehet, herët ose vonë, debatit klasik mbi shpirtin human dhe të nxënit, si dhe mësimëve të antikitetit për njerëzimin, që përcaktojnë sferat e arsimimit dhe formimin moral. Ashtu si arsimimi është ushtrim i aftësive mendore, formimi moral është edukimi i ndërgjegjes së brendshme, ndriçimi i vetë zemrës. Kështu, arsimimi dhe formimi moral janë dy elementë të pandarë të nxënies shpirtërore të njeriut, njëlloj si zogu që fluturon duke përdorur të dy krahët e tij. Në arsimimin e sotëm, sidoqoftë, këta dy elementë janë në një gjendje disekuilibri.

Arsimimi pa formimin moral mund të shndërrohet në një forcë destruktive ndaj karakterit të individit dhe vetë shoqërisë. Formimi moral pa arsimimin, edhe pse të orienton në një drejtësi morale, humbet me kohë dhe shndërrohet në një ngushëllim, si e vetmja strehë për njeriun. Për të rivendosur balancën mes asaj që njohim, ose është "e njohur" dhe asaj që është "e vlefshme" apo "mënyrës se si mund të jetë

më mirë”, duhet mbajtur parasysh se as arsimimi dhe as formimi moral nuk janë diçka që njeriu i fiton njëherë e përgjithmonë, si dhëmbët e pjekurisë që dalin pasi bien ata të qumështit. Arsimimi dhe formimi moral janë procese afatgjatë, të cilëve duhet t’u kthehemi në mënyrë të vazhdueshme e vigjilente, ashtu si zogu, që për të mbetur në ajër, i duhet të lëvizë në mënyrë të vazhdueshme të dy krahët.

Përktheu nga origjinali në serbisht Ben Andoni